

**MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIMIN
NË FUSHËN E SHËNDETËSISË PËR SHËRBIMIN E NDËRSJELLTË
NDËRKUFITAR
NDËRMJET**

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË SË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS
DHE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë, në vijim të quajtura “Palë”,

Të nxitura nga vullneti për të forcuar bashkëpunimin midis dy vendeve në fushën e shëndetit dhe shkencave mjekësore,

Të ndërgjegjshme që ky bashkëpunim do të ndihmojë në përmirësimin e kushteve të shëndetit të popullsisë përkatëse,

Bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të nxisin bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore duke u frymëzuar nga parimet e barazisë dhe përfitimit të ndërsjelltë.

Zbatimi i kësaj Marrëveshje dhe veprimtaritë e ndërmarra në përputhje me të do t'i nënshtrohen legjislacionit përkatës të palëve.

Neni 2

Palët do të angazhohen për të nxitur:

1. Organizimin e shërbimit të përzgjedhur shëndetësor nga mjekët e dy vendeve të zonave kufitare, sipas Planit të organizuar nga ministritë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve mjekësore të specializuara.
2. Ofrimin e shërbimit të urgjencës mjekësore për shtetasit e zonave kufitare në spitalet e zonave kufitare (Kukës, Gjakovë, Prizren) sipas nevojave të specialiteteve.
3. Shkëmbimin e ekspertëve dhe personelit shëndetësor ndërkufitar në funksion të mbështetjes mes dy vendeve për menaxhimin klinik të rasteve.
4. Bashkëpunimin në fushën e sigurimit të praktikës së mirë mjekësore, bazuar në dëshmi për trajtimin e pacientëve me COVID-19 ose me sëmundje infektive, në zonat ndërkufitare;

5. Bashkëpunimin dhe zbatimin e sistemit të alarmit epidemiologjik për kontrollin e ngjarjeve jo të zakonshme në zonat ndërkufitare.
6. Hetim dhe gjurmim të përbashkët epidemiologjik dhe shkëmbim informacioni për shtetasit e të dyja vendeve dhe zonave ndërkufitare për raste me COVID-19 dhe sëmundje të tjera infektive dhe bashkëpunimin ndërkufitar në lidhje me masat që ndërmerren në përballje me këtë sëmundje.
7. Trajnime të profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore dhe atyre të shëndetit publik të dy vendeve sidomos në zonat ndërkufitare;
8. Asistencë e ndërsjellë në pajisje, teste dhe produkte mjekësore në rast të nevojës.

Neni 3

Në zbatim të kësaj Marrëveshje, palët do të ndërmarrin plane veprimi për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore, të cilët do të përmbajnë aktivitetet e parashikuara në Marrëveshje.

Neni 4

Spitalet respektive të zonave kufitare do të sigurojnë ofrimin e shërbimit spitalor sipas kësaj marrëveshje, me buxhetin vjetor të alokuar.

Spitalet e cituara në këtë marrëveshje nënshkrujnë një protokoll bashkëpunimi me njëra tjetrën. Protokollin miratohet nga Komiteti i Përbashkët i Monitorimit dhe Koordinimit Shqipëri-Kosovë, i cili themelohet nga të dy palët.

Neni 5

Aktivitetet e parashikuara nga kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do të zhvillohen në përputhje me financimet e disponueshme në buxhetet e Palëve.

Neni 6

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi do t'i shtrijë efektet e saj për një periudhë 3 (tre) vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit dhe do të rinovohet automatikisht për periudha të njëjta, përderisa njëra nga Palët nuk heq dorë duke lajmëruar me shkrim Palën tjetër, të paktën gjashtë muaj para përfundimit të saj.

Në rast të heqjes dorë nga kjo Marrëveshje, veprimet e parashikuara do të mbeten në fuqi përsa i përket programeve të përbashkëta dhe angazhimeve përkatëse deri në përmbushjen e tyre.

Kjo Marrëveshje e hartuar në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, me tekste të barazvlefshme dhe mund të ndryshohet me pëlqimin reciprok të Palëve.

Bërë në Prishtinë, më 20 qershor 2022.

**Për Ministrinë e Shëndetësisë
së Republikës së Kosovës**

**RIFAT LATIFI
MINISTËR**

**Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale të**

**Republikës së Shqipërisë
OGERTA MANASTIRLIU
MINISTËR**